

L I G J
Nr.7958, datë 5.7.1995

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7745, DATË 26.7.1993 “PËR RISHPËRNDARJEN NË
VLERË TË PASURISË SË ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE” NDRYSHUAR ME
LIGJIN NR.7824, DATË 18.5.1994**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7745, datë 26.7.1993 “Për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore, ndryshuar me ligjin nr.7824, datë 18.5.1994 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas nenit 8 shtohet neni 8/a me këtë përmbajtje:

“Komisionet për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore të komunave apo bashkive, dorëzojnë dokumentacionin e rivlerësimit dhe rishpërndarjes në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore në komunë apo bashki.”

2. Pas nenit 10 shtohet neni 10/a me këtë përmbajtje:

“Komisionet e komunës apo të bashkive që veprojnë në kundërshtim me këtë ligj për plotësimin e dokumentacionit për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore, kur këto veprime nuk formojnë vepra penale, çdo anëtar i komisionit të komunës apo bashkitë në varësi të shkallës së përgjegjësisë, dënohet për kundërvajtje administrative nga 2000 deri në 3000 lekë.

Gjobat vendosen nga kryetari i këshillit të rrethit me propozim të kryetarit të komisionit të rrethit për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish kooperativave bujqësore.

Në rast se edhe pas kësaj mase kryetari i komisionit të komunës për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore nuk dorëzon dokumentet, denoncohet për ndjekje penale nga kryetari i komunës apo i bashkisë.”

3. Paragrafi i dytë i nenit 11 ndryshohet si vijon:

“Për personat juridikë a fizikë që janë debitorë dhe nuk përgjigjen për detyrimin në bazë të këtij ligji, vjelja bëhet nga zyra e përmbarimit të rrethit mbi bazën e paraqitjes së vendimit të ekzekutimit nga zyra e financës së komunës. Vjelja dhe rishpërndarja realizohet brenda muajit shtator 1995. Mbas kësaj date për çdo ditë vonese të shlyerjes së detyrimit debitori ngarkohet me 0.5 për qind të shumës së vlerës së papaguar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1152, datë 13.7.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha